



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 12.9.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtari nga Ministria e MMPH Miradije Gërguri dhe Luan Nushi, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 5.9.2011,**
3. **Shqyrtimi i Strategjisë për Biodiversitet,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me plotësimin e pikës së 4 me : shqyrtimin e planit për mihjen e re dhe shqyrtimin e projektligjeve që kanë ardhur për lexim të parë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.9.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5.9.2011.

3. Shqyrtimi i Strategjisë për Biodiversitet

Kryetari Nait Hasani theksoi se strategjia në fjalë vazhdon të shqyrtohet në mbledhjen e sotme ngase në mbledhjen e kaluar është dashur të shtyhet për shkak të qartësimeve të ndryshme dhe njoftimit më të hollësishëm nga ana e anëtarëve të komisionit. **Miradije Gërguri** nga MMPH tha se kjo strategji është dokument bazë për vlerat natyrore dhe krijon kornizën e aktiviteteve për shfrytëzimin e resurseve natyrore, bazën ligjore e ka në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës neni 141 pika 2. Gjithashtu ky dokument kujdeset për ruajtjen e botës bimore dhe shtazore në Kosovë. **Nait Hasani** rikujtoi se ky dokument ka ardhur në Kuvend me disa vërejtje nga vet propozuesi (Qeveria) rreth implikimeve financiare dhe është konstatua se buxheti i Kosovës nuk do të ngarkohet më tepër se që është propozuar, ngase Qeverisë i nevojitet një dokument bazë me çka do të krijohet baza për mbledhjen e donacioneve (shtoi përfaqësuesja e MMPH).

Liburn Aliu tha se shumë është e qartë pse duhet të kaloi ky dokument, mirëpo ai konstatoi se politika aktuale është në kundërshtim me politikën e biodiversitetit ngase brutalisht shfrytëzohet natyra, nuk respektohen ligjet kryesore mjedisore (VNM etj), megjithatë ai shpreson se tani ky plan i cili është dashur të jetë më i ashpër, do të jetë së paku i miratuar dhe institucionet kanë bazën ku do të mbështeten për të ruajtur natyrën. **Afërdita Berisha** gjithashtu u pajtua me këtë konstatim ngase ne duhet të kemi një plan për shfrytëzim racional të pasurive tona. **Nait Hasani** ftoi komisionin të miratohet ky plan i cili unanimisht nxori këtë :

R e k o m a n d i m **për mbledhjen plenare**

1. Komisioni miratoi projekt Strategjinë dhe Planin e Veprimet për Biodiversitetin 2011-2020 sipas vërejtjeve nga Qeveria (Departamenti për Buxhet nga Ministria për Financa), dhe i propozon Kuvendit të njëjtën ta miratoi.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet kryetari i komisionit Nait Hasani.

4. Të ndryshme

Ashtu si u vendos në fillim kryetari **Nait Hasani** ftoi **Luan Nushin** nga MMPH të arsyetoj Planin për Mihjen e re, i cili tha se ky dokument është derivat i Planit Hapësinor të Kosovës për një territor prej 150 km² dhe është shpallur si zonë e interesit ekonomik qysh më parë. Ky dokument mirët me zhvillimin hapësinor të asaj zone për 10 vite të ardhshme ku parashihen 3 milion euro në dy faza, dy herë nga 600 MGW, çka do të ndodhë me këtë hapësirë, si do të lëvizë popullata nga fshati në fshat dhe si do të trajtohet popullata, komunat që do të përfshihen (Obiliqi, Vushtrria, Drenasi dhe Fushë Kosova). Ai rekomandoi të miratohet në këtë komision por mos të vonohet edhe në Kuvend ngase është plan që nevojitet për zhvillimin e tenderëve në vijim. **Nait Hasani** pyeti për problemin e hirit për të cilin z. Nushi tha se me këtë plan është paraparë ndërtimi i fabrikës për përdorimin e hirit tash e tutje si material ndërtimor, ndërkaq rehabilitimi (pyetje nga **Liburn Aliu**) do të bëhet duke hapur dhe mbyllur gropat dhe në fund një gropë e madhe e cila do të shndërrohet në një zonë rekreative. **Nait Hasani** falënderoi për këto sqarime sidomos për fatin e hirit që krijon ndotje në sipërfaqet e konsiderueshme të Kosovës. Në fund Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

1. Komisioni miratoi draft Planin Hapësinor 2010-2020-Zona me interes të veçantë ekonomik “Fusha e mihjes së re”, dhe i propozon Kuvendit të njëjtën ta miratoi.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet kryetari i komisionit Nait Hasani.

Në vazhdim kryetari **Nait Hasani** propozoi që projektligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore të sugjerohet për miratim në parim ngase ligji në fuqi për këto rrezatime varet nga ky ligj. Komisioni nxori :

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim, Projektligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Dy shkresa

Kryetari Nait Hasani në vazhdim njoftoi komisionin me dy shkresa të cilat janë hartuar në emrin e këtij komisioni dhe të cilat kinse janë drejtuar nga kryetari i Komisionit Nait Hasani në gjuhën angleze personave Ms. Osnat Lubrani dhe Mr. Luan Shllaku me subjekt : Request. Meqenëse asnjëri nga anëtarët e komisionit nuk kishte dijeni lidhur me këtë çështje, komisioni vendosi që deri në mbledhjen e radhës **të kërkohen sqarimet e duhura**, nëse ka nevojë edhe të ftohen personat që do të japin sqarime.

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Kryetari **Nait Hasani** konstatoi se komisioni në mbledhjen e mbajtur më parë ka shqyrtuar këtë projektligj duke rekomanduar mosmiratimin e tij, mirëpo ky projekt prapë është dërguar në Kuvend pa ndonjë ndryshim rrënjësor. Në ndërkohë, vazhdoi, komisioni ka marr një Deklaratë nga Kuvendi i Prizrenit e cila do ti dërgohet mbledhjes plenare (kryetari e lexoi atë e cila kundërshton projektligjin në fjalë) si dhe reagimet tjera që kanë arritur në komision.

Liburn Aliu shtoi se projektligji i dërguar asgjë nuk ndryshon nga i mëparshmi dhe tha se ai i sheh tri probleme kryesore : 1. ky ligj trajton trashëgiminë kulturore por jo edhe të popullatës në tërësi para sllavëve, 2. ky ligj do të pamundësoi trajtimin shkencorë të monumenteve fetare-historike ngase autoriteti kishtarë serb nuk mund të jetë autoritarë për këto monumente dhe 3. kjo zonë ka edhe trashëgimi tjera siç janë islame, katolike etj dmth me këtë kundërshtohen edhe dispozitat e UNESCO-së sepse një autoritet (kisha ortodokse serbe) nuk mundet të jetë autoritare për monumente tjera joserbe. Dmth ky ligj do të dëmtoi kulturën e Prizrenit.

Salih Morina edhe një herë përsëriti se ky ligj duhet të jetë kompetencë e ministrisë së kulturës ndaj ne duhet të kemi një ligj të unifikuar për trashëgimi. Ai tha se ende qëndrojnë argumentet të cilat kanë qenë më parë për ta kthyer këtë projekt Qeverisë sidomos nëse kemi parasysh implikimet financiare që do të gjeneron, por edhe duke ja shtuar argumentin e qëndrimit të Kuvendit Komunal të Prizrenit. **Afërdita Berisha** shtoi se është nevoja për debat publik me qytetarët e Prizrenit. **Sevdije Lama, Rasim Demiri dhe Etem Arifi** konstatuan se asnjë fe nuk duhet të favorizohet, duhet të debatohet me qytetarë vendorë ngase në fund të fundit ata janë që dinë më mirë për territorin e tyre. Komisioni vendosi unanimisht :

R e k o m a n d i m për mbledhjen plenare

1. Të mos miratohet në parim, Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe ti kthehet Qeverisë në ripunim, për shkak të nevojës për një debat publik me qytetarët e Komunës së Prizrenit.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Kryetari Nait Hasani tha se ky rekomandim duhet ti dërgohet mbledhjes plenare me arsyetimin si vijon : Komisioni mori këtë rekomandim për mosmiratim duke pasur parasysh Deklaratën për këtë projektligj nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, Aneksin e parë të Pakos së Ahtisarit pika 4.1.7, reagimet kundërshtuese nga OJQ-të e ndryshme dhe arsyetimin e komisionit me faktin se në projektligj nuk ka risi, ai privilegjon KOS-in (kishën ortodokse serbe), gjithashtu kundërshtohen nenet si vijon : neni 4, neni 8 rreth aktiviteteve brenda qendrës, neni 12 rreth gjurmimeve arkeologjike, neni 16 dhe 16.7 rreth përbërjes së anëtarëve, neni 18 komplet,

sidomos 18.4 rreth komitetit, 18.5, neni 19 rreth kornizës për zbatim, neni 20.2 dhe 20.3 mbi moratoriumin, neni 23, neni 25 për menaxhim komplet. Komisioni në fund konstatoi se duhet të organizohet një debat i mirëfilltë me qytetarët e Prizrenit për të pasur një ligj të mirë. Këtij rekomandimi do të bashkëngjiten reagimet e cekura më lartë, por me rëndësi është të shtohet se ky ligj do të implikoi edhe financiarisht buxhetin e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,15. Mbledhja e radhës është më 19 shtator kur do të ftohet ministri i bujqësisë rreth debatit publik të mbajtur për Ligjin e Tokës Bujqësore.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani